



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 5202/prot.
/2

Tiranë, më 20.11 2019

VENDIM

Nr. 55, datë 20.11 2019

Për miratimin e formës së diplomës për programin e integruar të studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” në Fakultetin e Drejtësisë

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 91; Udhëzimin Nr. 5, datë 18.02.2009 “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga IAL”, i ndryshuar, Udhëzimin e MASR-së Nr. 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, dhe Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma cc), Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 20.11.2019;

VENDOSI:

1. Të miratojë formën e diplomës për programin e integruar të studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” në Fakultetin e Drejtësisë.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i përcillet për procedura të mëtejshme Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. MYNËR KONI

